



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA GRAMSH

RAPORTI TEKNIK
SISTEMIM ASFALTIM I RRUGEVE
TE FSHATI "CEKIN"

2020



1.1 - HYRJE

Gjeografia

Rrethi i Gramshit ndodhet në pjesën qendrore dhe jugore të Shqipërisë, nga Qafa e Shënkollit, Lleshan në veri deri në Siman(Sqimar) në jug dhe nga Saraseli në perëndim deri në malin e Valamarës, Lenie në lindje. Sipas të dhënave statistikore të viti 2004 ky rreth numëron 42616 banorë. Pjesa më e madhe e tij shtrihet në Krahinën Malore Qëndrore, e cila quhet Krahina e Vërçës. Kjo pjesë ndodhet në anën lindore të lumit të Devollit Pjesa lindore e tij shtrihet në Ultësirën Perëndimore, e njohur kjo si krahina e Sulovës dhe zona që shtrihet midis lumit të Devollit dhe të Tomorricës shtrihet në Krahinën Malore jugore dhe njihet si krahina e Tomorricës. Ky rreth shtrihet në sektorin e mesëm të lumit të Devollit, i cili brenda rrethit ka një gjatësi prej 49 km, lumë, i cili sic e thamë, sëbashku me lumin e Tomorricës e ndan Rrethin e Gramshit në 3 krahina. Rrethi i Gramshit bën pjesë në prefekturën e Elbasanit. Ai kufizohet nga shtatë rrethe të tjera të cilat janë; Elbasani, Librazhdi, Pogradeci, Korça, Skrapari, Berati dhe Kuçova, dhe ka një sipërfaqe prej 695 km². Përbëhet nga një bashki, 9 komuna dhe 95 fshatra. Sipas vendosjes gjeografike, ndodhet në zonën e klimës tranzitore, zonë që është mjaft e përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Këtë avantazh që ofron pozita gjeografike e dëmton karakteri i relievit, i cili në përgjithësi është mjaft i përthyer. Në tërësinë e vet territori i rrethit është një luginë. Lugina e Devollit dhe e Tomorricës përbëjnë pjesën më të shtruar të terrenit dhe ku gjenden edhe tokat më pjellore të tij. Në kurrizin jugor të vargut perëndimor janë zhvilluar mjaft fenomenet glaciale si liqene, të vendosura në lartësinë 1500-1800 m mbi nivelin e detit. Sipas ndarjes klimatike bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare kodrinore nënzona jugperëndimore që shtrihet deri në 800-1000m mbi nivelin e detit dhe në zonën klimatike mesdhetare malore nënzona juglindore pjesa e sipërme e relievit deri në lartësinë 2373m. Temperatura mesatare e ajrit është 12.3oC-15.1oC për Zonat e ulëta dhe 9.5oC-10.9oC për zonën malore. Në ndërtimin gjeologjik të rrethit të Gramshit marin pjesë kryesisht shkëmbinjtë sedimentarë dhe në sasi të pakët ata magmatikë. Nga studimet e bëra në rrethin e Gramshit njihen 70 shfaqje burimesh të mineraleve të dobishme, metalore dhe jo metalore si dhe minerale industriale ndërtimore. Vlejnë të përmenden ekspeditat gjeologjike të huaja dhe prezenca e disa shpimeve për kërkim nafte. Një ndër ta ndodhet në afërsi të fshatit Galigat. Në këtë rreth gjenden edhe burime të pastra të ujit të pijshëm me rezerva të mëdha, siç janë ujrat Sotires e Kerpices, ku prej këtij burimi furnizohet me ujë të pijshëm qyteti i Gramshit. Njihen gjithashtu burime ujrash Kurative si në Kërpicë, Holtë dhe Liçoni i Zi, të cilat nëpërmjet investimeve mund të përdoren për kurimin e



[Handwritten signature]

reumatizmës. Mund të themi se rrethi i Gramshit ka një hidrografi dhe hidrologji të zhvilluar. Rrjeti hidrografik është shumë i dendur dhe mjaft aktiv në periudhën e shirave. Burimet ujore përbëjnë një pasuri të madhe potenciale për zhvillimin e industrisë energjitike të rrethit, me kosto jo shumë të lartë. Studimi i bërë për shfrytëzimin e rrjedhjes së lumit Devoll ka nxjerrë si konkluzion se mbi të mund të ndërtohen tre hidrocentrale të mëdhenj. Njëri prej tyre, ai i Banjës. Aktualisht Gramshi ka dy hidrocentrale të vegjël, një mbi lumin Grabovë, në Lenie, me kapacitet 400kw/h, dhe një në fshatin Kërpicë, me kapacitet 200kw/h. Gjithashtu tashmë prej disa kohësh ka përfunduar edhe Hidrocentrali i Tërvolit. Lumi kryesor i rrethit është Devolli, i cili e përshkon atë thuajse mospërmas. Ai ka rëndësi të madhe ekonomike pasi në të dyja anët ka mjaft toka bujqësore të cilat ujiten prej tij. Në pasuritë ujore të Gramshit liqenet janë një pjesë e rëndësishme dhe nga elementët që krijojnë vende të bukura turistike. Ato gjenden të rrethuar nga pyje shumë të bukur ahu dhe rrotull tyre ka lëndina e kullota me sipërfaqe të konsiderueshme e bukuri përrallore në pranverë e verë. Gramshi është 97 km larg Tiranës, 94km larg Korçës dhe 47 km larg Elbasanit. Pra, duhet theksuar fakti se ai është rreth afër autostradave, veçanërisht pranë aksit perëndim-lindje: Durrës-Qafë Thanë-Pogradec-Korçë. Për ndërtimin gjeologjik, përcaktohet zhvillimi i territorit mbi shkëmbinjë kryesisht sedimentarë dhe më pak mbi magmatikë. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 804m, ajo më e larta është 2373m (Mali i Valamarës), ndërsa minimalja është 119m (i kërkohet autorit të këtij shkrimi të tregojë se ku ndodhet). Vendorsja e kësaj zone në një territor të pasur me resurse natyrore, të populluar që në lashtësi, të shoqëruar me zhvillime të hershme dhe të vrullshme historike, duke siguruar dhe vazhdimësinë iliro-shqiptare, kanë kushtëzuar larminë e madhe e të jashtëzakonshme natyrore dhe materialo-shpirtërore në zonat e vërejtura.



Kushtet natyrore



Handwritten signature

Rrethi i Gramshit bën pjesë në Krahina Malore Qendrore, Ultësirën Perëndimore, dhe Krahina Malore Jugore me një relief Kodrinoro malor, me një mesatare prej 804 m mbi nivelin e detit, me lartësi minimale 119 m mbi nivelin e detit dhe maksimale 2373 m. Ka një relief kryesisht të thyer, i cili vjen duke u ngritur nga perëndimi në drejtim të Lindjes. Lumi i Devollit është një urë ndarëse midis relievit më të ulët në perëndim dhe relievit më malor në lindje. Pikërisht në rrjedhjen e mesme të Devollit, aty afër mesit të gjatësisë së tij brenda rrethit të Gramshit, ndodhet qyteti i Gramshit, 230 m mbi nivelin e detit, ndërtuar ky në një nga tarracat lumore të krijuara nga lumi Devoll në këtë sektor. Përsa i përket ndërtimit gjeologjik, për rrethin e Gramshit përcaktohet zhvillimi i territorit mbi shkëmbinjë sedimentarë dhe më pak në ata magmatikë, këta të fundit gjenden më tepër në lartësitë e mëdha. Nga studimet e bëra në rrethin e Gramshit njihen 70 shfaqje burimesh të mineraleve të dobishme, metalore dhe jo metalore si dhe minerale industriale ndërtimore. Rrethi i Gramshit dallohet për një amplitudë të madhe hipsometrike, kjo për shkak të relievit shumë të thyer të tij, pasi në të janë të pranishme lartësitë 120m mbi nivelin e detit, por ka edhe lartësi që shkojnë deri në 2373 m mbi nivelin e detit, pa përmendur këtu malin e Tomorrit në kufirin jug-jugperëndimor të tij që arrin një lartësi maksimale prej 2415 m. këto kontraste kanë krijuar një relief të larmishëm, por gjithsesi duke mbetur brenda kuadrantit të relievit kodrinoro-malor.

Klima: Rrethi i Gramshit futet në zonën klimatike mesdhetare kodrinore nënzona jugperëndimore që shtrihet deri në 800-1000m mbi nivelin e detit dhe në zonën klimatike mesdhetare malore nënzona juglindore pjesa e sipërme e relievit deri në lartësinë 2373m. Temperatura mesatare e ajrit është 12.3oC-15.1oC për Zonat e ulëta dhe 9.5oC-10.9oC për zonën malore. Mund të themi se temperatura mesatare e ajrit është/varion nga 12.3oC deri 15.1oC për zonat e ulëta dhe 9.5 oC deri 10.9 oC për zonat malore. Niveli i reshjeve varion, por mestarje e tyre është afërsisht 1200 mm shi në vit. Reshjet më së shumti janë në formë në shiut, por në zonat malore bien edhe reshje dëbore të cilat qëndrojnë pa shkrirë 2 deri në 3 muaj në vit. Reshjet më së shumti janë të përqëndruara në stinën e dimrit, vërehet një maksimum në nëntor dhe një minimum në korrik. Kushtet klimatike në përgjithësi janë të përshtatshme për zhvillimin ekonomik, sidomos atij bujqësor dhe blektorial, pasi sic e theksuam edhe më lart temperaturat janë optimale, gjithashtu edhe reshjet janë të mjaftueshme. Shumë mirë këto reshje mund të shfrytëzohen për rritjen e kulturave bujqësore, pasi ajo lejon që të paktën në lartësitë më të vogla të merren edhe dy produkte bujqësore në vit, por gjithsesi ndihet nevoja e ujitjes artificiale sidomos në periudhën me reshje të pakëta, gjë e cila mund të rregullohet nëpërmjet shfrytëzimit të lumit të Devollit, ku në bazë të tij janë ngritur një rrjet kanalesh ujitëse, në kohën para viteve '90 rreth 30% e sipërfaqes së rrethit u vendos nën



[Handwritten signature]

ujë. Gjthashtu një klimë e tillë ndikon pozitivisht edhe mbi shëndetin e njeriut, sidomos nbi luginën e Devollit, prandaj përqëndrimet e popullsisë janë më të mëdha mbi të ose shumë afër tij.

Hidrografia

Rrethi i Gramshit ka një hidrografi të pasur si me ujëra sipërfaqësore ashtu edhe nëntokësore, edhe pse burimet aktive gjithëvjetore janë të dendura vetëm nga lartësitë 1000 m mbi nivelin e detit, ndërsa në zonën e poshtme ato janë të rralla. Këtu mund të përmendim dy lumenjtë kryesorë të rrethit Devolli me gjatësi brenda tij 49km dhe Tomorrë me një gjatësi prej 14km, gjithashtu janë të pranishme edhe disa lumenj të tjerë, por më të vegjël si ai i Holtës, Lenies, etj. Ndër liqenet mund të përmendim më të rëndësishmin prej tyre, liqenin e Dushkut me sipërfaqe prej 1km². Në rrëzë të malit të Tomorrit gjendet burimi i Kerpices, që furnizon qytetin e Gramshit dhe shumë fshatra në të cilat kalojnë tubacionet e ujit të pijshëm, por edhe më gjërë, me ujë të pijshëm. Mund të themi se vetëm gjysma e tij shfrytëzohet për ujë të pijshëm, pjesa tjetër shfrytëzohet për prodhimin e energjisë në hidrocentralin e Kerpices. Gjithashtu, të pakëta por jo të parëndësishme janë dhe ujërat termale, të cilat kanë një shfrytëzim të kufizuar vetëm për popullsinë e zonës. Pra duke bërë një vlerësim të hidrografisë, mund të themi se ky rreth është mjaft i pasur me ujëra, si për të pirë, për ujitje dhe për aktivitete të ndryshme të ekonomisë siç mund të përmendim mullinjët e bluarjes së miellit, të cilët përdorin ujin e rrjedhshëm 24 h për ushtrimin e aktivitetit të tyre punues. U bënë tashmë 8-9 vjet që qyteti i Gramshit ka ujë 24 h në ditë.

Tokat: Rrethi i Gramshit për vetë nga lartësitë mbi nivelin e detit që variojnë ka të pranishme disa lloje tokash, të cilat janë: Tokat e imëta kafe, të pranishme kryesisht nga lartësia 119 deri në 600-700m mbi nivelin e detit. Tokat e kafenjta, nga 700-1000 m Tokat e murrme pyjore, 1000 deri 1600-1800 m Tokat livadhore malore, mbi 1800 m mbi nivelin e detit.

Prania e këtyre tokave ka kushtëzuar edhe bimësinë, si atë natyrore dhe atë të kultivuar, tek këta të fundit përmendim praninë e pishave pranë fshatit Pishaj të pazakonta për këtë lartësi.

Ndër katet bimore mund të përmendim

Zonën e dafinës deri në 1000 m Zonën e ahut, 1700-1800 m Zonën e rrobullit, 1800-2000 m Zonën e kullotave sub-alpine, 1800-2373 m mbi nivelin e detit.

Veshja bimore, klima, toka kanë qënë kushte që megjithë ndryshimet e pësuar, edhe sot vlerësohen relativisht të përshtatshme për faunën e Gramshit. Veprimtaria njerëzore prishi ndjeshëm zinxhirin jetësor të llojeve të veçanta, po ashtu edhe në dëndësinë e "banorëve" të egër në territorin aktual. Ekuilibret e reja nuk janë edhe aq të favorshme për shtimin dhe përhapjen e tyre. Gërryerja e tokës, presioni i aktivitetit të



[Handwritten signature]

njeriut në mbulesën bimore sjell shkatërrimin e vendbanimeve, pakëson ndjeshëm ushqimin dhe mundësinë për të përballuar faktorët klimatikë dhe "stresin" tek mjaft lloje kafshësh dhe shpendësh. Administrimi i faunës ekzistuese, sado i "disiplinar" me shkresa e ligje, mbetet aktivitet në duart e pakontrolluara dhe spontane me rezultate të pafavorshme për këtë pjesë të botës së gjallë të territorit të rrethit (dhija e egër, gjeli i egër, kaprolli, etj.)

Ekonomia

Periudha socialiste . Rrethi i Gramshit historikisht renditet ndër zonat me zhvillim të ulët ekonomik. Në vitet e të ashtuquajturit kolektivizimi socialist në fshat karakterizohet nga ekonomia e mbyllur, kurse në qytet industria filloi të merrte fizionominë e vet mbas viteve 1960 me ngritjen e Uzinës Mekanike të Çekinit e të fabrikave të tjera që e pasuan atë. Banorët e këtij rrethi historikisht janë marrë me blegtori e bujqësi dhe një pjesë me përpunimin e drurit. Reformat për thellimin e revolucionit socialist në bujqësi dhe politika e centralizuar demografike, çoi në ngushtimin e pronës private deri aty sa disa fshatra (Shemriza, Lubinja, Gurrëza, Ostenthi, Trashovica, ish-kooperativa bujqësore e Darzezës) mbas vitit 1981 në emër të "inisiativës" nga poshtë nuk lejoheshin të mbanin asnjë lopë ose familjet e reja që ndaheshin nga trugu nuk mund të mernin tokë sa gjithë familjet e tjera. Si rezultat i ngushtimit artificial të "Oborrit kooperativist" fshatari gramshiot në vitet 1985-1991 detyrohej të blinte në tregun e qytetit produkte të tilla si djathin, gjizën, gjalpin, mishin etj. Ky ishte ndoshta paradoksi më i madh. Gjatë viteve të kooperativizimit, blegtorja, jo vetëm nuk u zhvillua intensivisht, por mbeti mbrapa edhe nga pikpamja ekstensive. Numri i bagëtive të imëta gjatë këtyre viteve ishte 2 herë më i ulët se para kolektivizimit. Nga regjimi i kaluar Gramshi trashëgoi industrinë ushtarake ku përfshihen Uzina Mekanike e Çekinit dhe Uzina e Prodhimit të Baterive, industrinë e përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale ku përfshihen Fabrika e konservave, Fabrika e pijeve freskuese dhe atyre alkoolike, linjat e përpunimit të qumështit në qytet e disa fshatra, industrinë e materialeve të ndërtimit, veçanërisht të inerteve, industrinë e prodhimit të produkteve prej thupre e kashte misri për eksport, disa reparte mekanike të përpunimit të drurit etj. Bujqësia është dega bazë e ekonomisë së rrethit, ajo zë 65% të GDP. Çdo familje fshatare në Gramsh ka në pronësi 0,97ha tokë arë ose 0.2 ha për frymë, sasi kjo e pamjaftueshme për zhvillimin e një ekonomie bujqësore me kërkesat e ekonomisë së tregut. Ndër kulturat e drithërave gruri zë peshën specifike më të madhe. Ai zë aktualisht 46% të sipërfaqes së mbjellë me bimë arësh dhe 72% të prodhimit të drithërave të bukës Me misër mbillet 21% e sipërfaqes që zënë drithërat e kjo kulturë jep 27% të prodhimit të drithërave. Pësha specifike e misrit për për prodhim buke po vjen duke rënë çdo vit.



[Handwritten signature]

më gjërë përdoret si ushqim për blegtorinë. Gramshi është i njohur për prodhimin e duhanit. Sot sipërfaqja e mbjellë me duhan ka rënë, po kështu edhe rendimenti. Çmimi që ofrohet për blerjen e prodhimit të duhanit nuk i nxit fermerët të meren me kultivimin e tij. Me mikroklimat që ka Gramshi është rreth që kultivohen një numër i konsiderueshëm perimesh, rreth 20 lloje, si patatja, fasulja, domatja, qepa, preshi, trangulli (kastravec), speci, hudhra, bamja, patëllxhani, bostani, shalqini, sallata, mashurka, panxhari i kuq, karrota, kungulli, lakra, spinaqi e deri tek erëzat e ndryshme. Perimet që kultivohen masivisht në këtë rreth janë patatja, fasulja, domatja, trangulli, qepa, preshi, hudhra e lakra. Rrethi i Gramshit ka tradita edhe në pemëtari e vreshtari. Mikroklima që ai ka bëjnë të mundur që të kultivohen një numër i konsiderueshëm frutash si rrushi, fiku, molla, dardha, kumbulla, qershia, pjeshka, hurma, arra, gështenja, shega, kajsia, ulliri, bajamja etj. Kushtet natyrore të relievit krijojnë mundësi për mbarështimin e blegtorisë, veçanërisht të deles e të dhisë, por edhe të gjedhit e të një thundrakëve. Në Gramsh rriten edhe mjaft shpendë të butë si pula, rosa, pata e gjeli i detit. (Në fshatin Çekin ndodhet edhe një pulari për mbarështimin e pulave). Gramshi njihet edhe për mbarështimin e bletës duke shfrytëzuar masive kullësore. Mjalti i prodhuar sidomos në zonën e Vërçës është i një cilësie të lartë me vlera kurative.

Kultura

Qyteti ka një Pallat Kulture që quhet "Thoma Prifti" ku mblidhen fëmijët, të rinjtë dhe të gjithë të talentuarit në fushën e artit dhe ku mund të shpalosin talentin e tyre në shume drejtime si : këngë, kërcim (popullor dhe modern), humor etj. Gramshi është një qytet mjaft i gjallëruar dhe njëkohësisht një vend ku mund të jetosh i qete, larg zhurmave dhe ajrit super të ndotur të qyteteve të mëdha.

Ka edhe një klub futbollit i cili quhet : KF Gramshi. Gjithashtu ka të zhvilluar shume edhe sportin e volejbollit (për femra). Gjithashtu ka dhe një pallat sporti dhe një kënd sportiv. Gramshi është shume i njohur për muzikën e tij popullore. Nga gjiri i tij kane dale shume këngëtare me zërin si bilbil. Karakteristika më e dalluar e Gramshit në Muzikën burimore janë 'FYEJT E GRAMSHIT', të cilët kanë marrë vlerësime nga shumë studiues të folklorit tonë. Aktiviteti më i rëndësishëm kushtuar këtij instrumenti ishte festivali që u mbajt vitin e kaluar (2010) në datat 2-3 qershor nën titullin 'Festivali Mbarëkombëtar i Fyejve'. Shpresojmë që ky aktivitet i iniciuar nga Pallati i Kulturës 'Thoma Prifti' të vazhdojë traditën e nisur. Gjithashtu një pjesë e dalluar e kulturës së Gramshit janë edhe Lojërat Popullore. Disa e kanë vlerësuar si gjënë më të rëndësishme të kulturës së Gramshit.

Politika



Vlerësimi i potencialeve natyrore dhe humane për zhvillimin e kësaj zone

Rethi i Gramshit është një rreth që ka një pozitë të favorshme gjeografike dhe një klimë që është shumë e përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë së tij, por këto favore dëmtohen nga karakteristikat e relievit, që përgjithësisht është e përthyer (kodrinormalor). Por këtë reliev të përthyer mund ta vlerësojmë për pasurinë e peizazheve që na ofron. Në rrethin e Gramshit gjenden luginat e gjëra lumore deri tek kanionet, burime të shumta ujore e ujëvara, ujra të pijshëm e termale, kodra e deri tek malet më të larta të zonës të mbuluar pothuajse gjysëm viti me dëborë, zona të zhveshura, por edhe hektarë të tërë me pyje rrobulli, ahur e pishe. Të gjitha këto pasuri bëjnë që në të të krijojnë lloje të ndryshme vendbanimesh, të cilat edhe këto formojnë një peizazh interesant kryesisht në zonat rurale. Gjithashtu këto pasuri përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë sidomos sektorit të tretë dhe më saktësisht të disa llojeve të turizmit si: turizmi i bardhë në Malin e Valamarës, turizmi kurativ duke shfrytëzuar burimet e liqenit të Zi, turizmi kulturor e fetar në Grabovën e Sipërme etj. të gjitha këto janë një potencial të cilëve në qoftë se u jepet vëmendja dhe mbështetja e duhur nga organet përkatëse, duke dhënë investimet e duhura, pa frikë brenda një kohe shumë të shkurtër mund të zërë vendin e parë në të ardhurat që ajo mund të sjellë në ekonominë e këtij rrethi. Gjithashtu një potencial i rëndësishëm është edhe popullsia vitale e kësaj zone. E them këtë sepse numri më i madh i popullsisë është midis moshës 14-64 vjeç (22122 banorë kundrejt 11527 banorë të moshës deri në 14 vjeç dhe 2101 të moshës 65 e lartë). Pra popullsia e rrethit të Gramshit është akoma e re, gjë që bën të jetë një forcë e madhe pune e cila është në kërkim vetëm të punës, që në rrethin e Gramshit mungon, si rrjedhojë kjo popullsi vitale dhe aktive për punë është e detyruar të emigrojë.

Problemet aktuale dhe e ardhmja, perspektiva e zhvillimit ekonomik të kësaj zone

Problemet aktuale që bëjnë pjesë në rrethin e Gramshit janë disa. Pas rënies së sistemit socialist dhe nga kalimi i ekonomisë nga ekonomi socialiste në ekonomi tregu, e dëmtoi rëndë ekonominë e këtij rrethi. Por e meta më e madhe është se ajo edhe në kohën e kolektivizimit nuk pati ndonjë rritje, madje mund të themi që pati një stanjacion në disa raste edhe hapa mbrapa, deri në atë pikë sa fshati gramshiot i blinte në qytet produkte blektorale, si bulmet e mish, perime e produkte të tjera që mbilleshin në fshat. Me kolektivizimin numri i bagëtive ra, si rrjedhojë edhe rendimenti i tyre pavarësisht se u bë një përpjekje për përmirësim racor. Gjithashtu nuk mund të mohohen një sërë uzinash e fabrikash të cilat u ngritën në periudhën socialiste dhe u siguronin punë një numri të madh të popullsisë, por që me privatizimin e tyre dolën mjaft të papunë. Kjo erdhi për shkak se nuk kishte kapital investues gjithashtu teknologjia e tyre ishte shumë e



[Handwritten signature]

vjetër dhe nuk jepte rendiment. Unë në fund të çdo çështjeje e çdo mundësie që ekziston për zhvillim kur kam trajtuar objektet punëdhënëse në periudhën socialiste jam munduar ti jap edhe një zgjidhje të mundshme për këto potenciale, të cilët mund të punesonin në punë një numër të madh të popullsisë sidomos të qytetit dhe të disa fshatrave afër tij meqënëse këto objekte lokalizohen më tepër në territorin e qytetit. Duke u bërë më shumë investime në vend do të mund të ulej edhe numri i të larguarve si brenda ashtu edhe jashtë vendit , kapitali i tyre do të investohej për zhvillimin e rrethit të tyre si rrjedhojë do të ndodhte edhe një riaktivizim i këtij rrethi. Mendohet që, në qoftë se në rrethin e Gramshit do të ndërtohen tre hidrocentralet që janë parashikuar për t'u ndërtuar, jeta në këtë rreth mund të ndryshojë. Ai mund të bëhet rrugëkalimi midis lindjes dhe perëndimit, duke u lidhur kështu me Korçën (rrugë nacionale), Pogradecin, Beratin, Kuçovën etj., duke shkurtuar kështu disa km rrugë, gjithashtu duke bërë të mundur hapjen e rrethit të Gramshit pasi deri tani ai është si një xhep i cili ka lidhje vetëm me Elbasanin dhe Cerrikun. Po të shfrytëzohen siç duhet pasuritë hidrike, përfitimet do jenë jo vetëm për këtë territor, por edhe për gjithë Shqipërinë.

1.2 - VEND NDODHJA E OBJEKTIT

Objekti **Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Cekin**", ndodhet ne pjesen veriore te Rrethit te Gramshit, ne veri te qytetit Gramsh.



[Handwritten signature]

Objekti fillon ne hyrje te fshatit Cekin qe eshte 1 klm nga hyrja e qytetit ne brendesi te fshatit dhe perfundon ne dalje te fshatit Cekin ne veri te ketij fshati.

Rruga ka nje gjatesi rreth 3km dhe kalon ne nje terren kodrinor. Vec fshatit te Cekinit, per te cilin sherben si aks i vetem nga kjo rruge perfitojne ne menyre indirekte edhe zonat perreth, sidomos fshatrat Storr 1 dhe Storr 2, Tervol. Ne total numri i banoreve qe mund te shfrytezojne kete rruge shkon rreth 2500 banore.

Rrethi i Gramshit



1.3 - GJENDJA AKTUALE E OBJEKTIT

Gjendja e objektit paraqitet:

Kjo rruge qe sherben per grupet e banimit ne kete fshate eshte gati 3 klm e gjate.

Ky segment ka nje gjeresi mesatare deri ne 5m. Kthesat per shkak te konfigurimit te terrenit jane me rreze te vogla. Traseja eshte e shtruar me nje shtrese zhavorr 15-30cm, e cila ne shume vende ka demtime dhe deformime. Ujrat siperfaqesore, megjithese ne zona te caktuara ka prezent nje kanal anesor, por qe pothuaj ka dale jashte funksioni, rrjedhin neper trup te rruges duke demtuar shtresat ose ne raste te vecanta ne skarpata duke krijuar gerryerje.



Eduart Bushi

Neper kthesa mungojne teresisht sinjalistika dhe elemntet e sigurise rrugore. Por ato jane parashikuara te ndertohen simbas kushteve teknike dhe standarteve bashkohore.

Tombinot jane teper te rralla dhe shpesh jashte funksioni. Jane parashikuara te vendosen atje ku mungojne me dimesjone dhe permasa sipas percaktimit ne projekt.

Pergjithesisht rruga eshte e shtruar me nje shtrese te holle zhavorr lumi 5-15cm, teper e demtuar me gropezime dhe valezime te cilat jane parashikuar ne projekt qe te ndertohen te gjitha shtresat qe kerkohen. Kanalet anesore jane pjeseisht ekzistues, por shpesh nuk arrijne te kryejne funksionine tyre. Veprat e artit, megjithese te pakta (ndonje tombino ose mur mbajtes) jane te degraduara nga koha dhe mungesa e mirembajtjes. Trupi i rruges ka gjeresi 3-3.5m

Pergjate rruges, kalon edhe linja e ujesjlesit (ndertuar me tub celiku). Pergjithesisht kjo linje eshte ndertuar jane trasese se rruges. Ne zona te vecanta ajo intersekton rrugen, ose shtrihet te trup te saj. Thellesia e vendosjes se tubit ne keto raste eshte e vogel, gje qe mund te sjelle demtimin e linjes nga trafiku dhe sidomos gjate kryerjes se punimeve.

Pergjate rruges linja e ujesjellesit ka edhe disa puseta, te demtuara te cilat duhet rikostruktuar dhe spostuar, jashte trupit te rruges.

Edhe ne kete segment rrugor, ashtu si me pare, traseja eshte e shtruar me nje shtrese zhavorr lumi, e cila vende vende eshte zhdukur teresisht. Rruga ka nje gjeresi variabel nga 2.5-3m. Ne vende te vecanta per shkak te rrethimeve, apo te shkarjeve te skarpatave, gjeresia eshte me e vogel, duke bere te veshtire kalimin e mjeteve, sidomos ne dite me kushte te keqija atmosferike, apo naten, ne mungese te pamjes.



2. - ZGJIDHJA E PROJEKTIT

2.1 - PROJEKTI I RRUGES

Projekti eshte hartuar ne perputhje me kerkesat e Termave te References te dhena nga Bashkia Gramsh.

Objektivi kryesor i Bashkise Gramsh, eshte rikonstruksioni i plote i kesaj rruge. Kjo konsiston ne ndertimin e shtresave te reja rrugore, veprave te artit sipas nevojave qe paraqet rruga, sistemimin e ujrave siperfaqesore (te shiut) si dhe sinjalistiken rrugore ne menyre qe te rriten parametrat e levizjes dhe sigurise rruugore.

Ne zgjidhjen e projektit, duke patur parsysh edhe shtrirjen e ketij objekti, zonat qe ai lidh dhe fluksin relativisht te ulet te levizjes, projekti ka prashikuar ndertimin e rruges me gjeresi te pjeses se asfaltuar 4 m dhe bankina nga 0.5m.

Pjesa e pare e rruges qe fillon me nje ngjitje sipas pjerresis se kodres, nepermjet disa kthesave ka ne gjatesi rreth 0.7 klm. Ne kete segment rruga paraqitet e ngushte, ato kane materiale te shkriфта dhe qe krijojne probleme sidomos ne kohe me lageshti.

Per sa i perket te gjithë rruges se fshatit Cekin:

Traseja ndertohet pergjithesisht mbi ate ekzistuese, duke bere zgjerimet e nevojshme per arritjen e gjerese se kerkuar 4 m pjese e asfaltuar dhe 0.5m bankina. Sipas rastit perkates zgjerimi perfshin edhe pjesen e kthesave dhe ate per vendosjen e sistemit kullues te ujrave te shiut dhe veprave te artit. Zgjerimi ne pergjithesi eshte parashikuar te behet nga ana e siperme me germim. Per trupin e rruges pjese e zgjeruar dhe zonat ku bazamenti ekzistues (zhavorri) eshte teper i demtuar apo i larguar nga trafiku, rruga do trajtohet me kasonete me thellesi 20 cm. Fillimisht kasoneta do cilindrohet dhe me me pas mbi te do ndertohet shtresa prej 20 cm zhavorr. Mbi kasonete dhe rrugen ekzistuese do ndertohen shtresat rrugore sipas paketes te dhene ne profilin tip perkates.

Materiali kryesor ndertimor per nenshtresat e rruges do te jete:

Zhavorri i lumit (per pjesen kasonete dhe shtrese profiluese), Çakelli, stabilizanti, kurse per shtresat e siperme do te jete binderi dhe asfaltobetoni.

Si pakete baze ne ndertimin e ketij segmenti rrugor, duke u nisur dhe nga rekomandimet e dhena nga studimi gjeologo-inzhinierik do jete (sipas llogaritjes se shtresave, raporti bashkelidhur).



[Handwritten signature]

- | | |
|--------------------------|-------|
| • Asfaltobeton | 4 cm |
| • Binder | 5 cm |
| • Stabilizant | 10 cm |
| • Cakell dhe Zhavor lumi | 20 cm |

Ne zonat ku e lejon terreni jane parashikuar vend pushime.

Bordurat dhe Kunetat

Ne zonat e banuara, trupi i rruges sipas zonave perkatese te dhena ne projekt do të kufizohet me bordurë Betoni Parafabrikat M-250 me përmasa 15x30cm të fiksuara me beton M-100. Ne zona me formacione te shkripta dhe me skarpata te larta, per te minizuar zgjerimin jane perdorur bordura me lartesi 60cm (si mure te vegjel prites) me qellim mbajtjen paster te trupit te rruges dhe pritjen e materialeve te imta nga skarpata.

Kuneta do të jetë e shtruar me beton me trashësi mesatare 10cm. (me këtë realizohet përrësia tërthore e kunetës prej 8%).

KONKLUSIONE

Sistemim asfaltim i rrugeve te fshatit "Cekin", do te kete nje impakt teper pozitiv per banoret e kesaj zone. Perfitues te drejtperdrejte jane banoret e fshatit Cekin, por ne menyre indirekte perfitojne edhe fshatrat Stror, Tervol, duke krijuar nje mundesi komode levizjeje per banoret e ketyre fshatrave.

Ndertimi i kesaj rruge do i jape nje permiresim te ndjeshem te kushteve higjenosanitare dhe qarkullimit te banoreve brenda fshatit Cekin.

HARTOI
EURO 2003
KONS. ING. EDUART BUSHI

Sup. Eduart Bushi
EB



EB